



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 588/2 Prot.

Tiranë, më 18.03.2026

VENDIM

Nr. 21 Datë 18.03 2026

“PËR

**MIRATIMIN E BURSIVE TË STUDENTËVE DHE PËRJASHTIMIN NGA
TARIFA E SHKOLLIMIT TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, PËR VITIN
AKADEMIK 2025-2026 NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS”**

Mbështetur në nenin 49 të Ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në nenin 43 të Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, në zbatim të VKM nr. 903, dt. 21.12.2016, "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", të ndryshuar, me VKM nr. 39 datë 23.01.2019, VKM 269 datë 29.03.2017 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të integruar të studimeve... që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit", të ndryshuar me VKM nr. 40 datë 23.01.2019, në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 32 datë 23.06.2025 "Për miratimin e tarifave të regjistrimit për konkurs regjistrimit të fituesve për ciklin e parë, të dytë dhe të tretë të studimeve dhe tarifave të shkollimit për të tre ciklet e studimeve në UST", në Vendimin nr. 52 datë 22.10.2025 "Për miratimin e formularëve për përfitim burse, përjashtim nga tarifa e shkollimit për studentët e ciklit të parë dhe reduktim me 50% nga tarifa e studimit për studentët e ciklit të dytë, për vitin akademik 2025-2026 në UST", në Relacionin e Komisionit të shqyrtimit të dokumentacionit me Nr. 450 prot., datë 26.02.2026 "Mbi shqyrtimin e dokumentacionit përkatës për aplikimet për bursë dhe përjashtim nga tarifa e studimit për ciklin e parë të studimeve", në relacionin e Adm. Nr 450/1 prot. datë 02.03.2026, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 18.03.2026,

V E N D O S I :

1. Miratimin e listës së studentëve që ndjekin studimet në ciklin e parë të studimeve, program i parë, në Universitetin e Sporteve të Tiranës dhe plotësojnë kriteret për të përfituar bursë, dhe për tu përjashtuar nga tarifa e shkollimit për vitin akademik 2025-2026, sipas kriterëve të detajuar, Kriteri 1, tabelat bashkëngjitur;
2. Miratimin e listës së studentëve që ndjekin studimet në ciklin e parë të studimeve, program i parë, në Universitetin e Sporteve të Tiranës dhe plotësojnë kriteret për të

përfitur bursë, dhe për tu përjashtuar nga tarifa e shkollimit për vitin akademik 2025-2026, sipas kriterëve të detajuar, Kriteri 14, tabelat bashkëngjitur

3. Shpenzimet për bursat e studentëve mbulohen nga buxheti i Universitetit të Sporteve të Tiranës për vitin akademik 2025-2026, dhe efektet financiare llogariten sipas datës së aplikimit.
4. Ky vendim bashkë me listën e studentëve që përfitojnë dhe me efektet financiare duhet të dërgohet në MA dhe AKFAL.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Drejtoria e Financës dhe Buxhetiti, FSHL, FVFR ,Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademike-Shkencore të Universitetit të Sporteve të Tiranës.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Artur ÇOBANI



Kriteri nr.1: Studentët familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike

Nr.	Nr. matrikullimi	Emër Mbiemër	Nr. prot	Data	Fakulteti	Viti	Efektë Financiar i përjashtimit	Efektë i Bursës
1	EF813A120219	Orgis Çerkezi	2942/22	11.12.2025	FSHL	3	35,000	90,000
2	EF813A130446	Albulena Domi	2942/58	15.12.2025	FVFR	2	17,500	90,000
3		Marilda Tota	267	03.02.2026	FSHL	1	17,500	49,545
Total							70,000	229,545

Kriteri nr. 14: Studentët të cilët kanë të paktën njërin prind person me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me KMCAP, përfitues i pagesës së aftësisë të kufizuara

Nr.	Nr. matrikullimi	Emër Mbiemër	Nr. prot	Data	Fakulteti	Viti	Efektë Financiar i përjashtimit
1		Sokol Xhaferri	360/2	18.02.2026	FVFR	2	17,500
2		Resart Cengu	360/1	18.02.2026	FVFR	3	17,500
Total							35,000

Sonila Shera



Alsona Ivani



Eduard Meçaj

